

**ÇFARË KA PËR QËLLIM LIGJI PËR  
RIMËKËMBJE EKONOMIKE? - 3**

**ÇFARË PARASHEH LIGJI PËR RIMËKËMBJE  
EKONOMIKE PËR SUBVENCIONIMIN E  
KONSUMATORËVE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE? - 4**

**SA JANË ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE  
DHE SI ÇAKTOHEN? - 5**

**ÇFARË JANË TARIFAT NXITËSE DHE SI  
PËRCAKTOHEN? - 7**

**SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE PARA  
DHE PAS PANDEMISË - 9**

**SEKTORI I ENERGJISË  
ELEKTRIKE PARA DHE  
PAS PANDEMISË**

# PËR BULETININ

Qëllimi kryesor i Buletinit të Rimëkëmbjes është që në baza mujore, të shpalos dhe ofrojë informata të përgjithshme tek publiku i gjerë rreth masave të ndërmarra nga institucionet tona sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. Këto masa janë inicuar me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes ekonomike në vend, pas pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Përveq se të informojë qytetarët rreth masave të rimëkëmbjes, ky buletin synon që të paraqet nivelin e zbatimit të masave krahas inkurajimit të hisedarëve drejt monitorimit të zbatimit të tyre.

Ky edicioni i buletinit shtjellon temën e subvencionimit të tarifës së Burimeve të Ripërtrishme (BRE-ve), tarifave nxitëse dhe se në çfarë mënyra është duke u drejtuar kjo mbështetje me qëllim rimëkëmbjen ekonomike. Buletini i Rimëkëmbjes synon që me anë të intervistave me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për temat e caktuara të buletinit të sjellë pikëpamjet e tyre për problematikat e fushës. Krahas kësaj, INDEP ka zhvilluar intervistë edhe me përfaqësuesit dhe drejtuesit e ZRrE-së, të cilët na kanë informuar rreth çështjeve të ndryshme mbi sektorin e energjisë.

**BULETINI I  
RIMËKËMBJES  
REALIZOHET SI  
PJESË E PROJEKTIT  
“BAROMETRI I  
RIMËKËMBJES – PËR  
TRANSPARENCË  
DHE  
LLOGARIDHËNIE”  
MBËSHTETUR NGA  
FONDACIONI I  
KOSOVËS PËR  
SHOQËRI TË HAPUR  
(KFOS).**



## ÇFARË KA PËR QËLLIM LIGJI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE?

Sikurse në të gjitha vendet e tjera të botës, edhe ekonomia e Kosovës është prekur nga pandemia COVID-19. Kjo gjendje ka ndikuar që shumë subjekte ekonomike të punojnë në kapacitete të limituara ose në raste të caktuara të mbyllen tërësisht. Si përgjigje ndaj kësaj situatë, Qeveria e Kosovës ka miratuar Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike përmes të cilit përcakton masat e nevojshme për rimëkëmbje ekonomike. Në kuadër të këtyre masave është edhe subvencionimi i tarifës së BRE-ve për të gjithë konsumatorët për 5 muaj për periudhën 01 janar deri më 31 maj 2021.

**NENI 15 I LIGJIT NR. 05/ L-084 PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË, PARAGRAFI 1, PAS NËN-PARAGRAFIT 1.1.2., SHTOHET NJË NËN-PARAGRAF I RI ME NUMËR RENDOR 1.1.2.A., 1.1.2.A. QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË KUADËR TË PROGRAMIT PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE, SUBVENCIONON TARIFËN E BURIMEVE TË ENERGJISË SË RIPËRTRISHME (BRE) PËR TË GJITHË KONSUMATORËT PËR PESË (5) MUAJ PËR PËRIUDHËN 01 JANAR 2021 DERI MË 31 MAJ 2021.**




## ÇFARË PARASHEH LIGJI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE PËR SUBVENCIONIMIN E KONSUMATORËVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE?


Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike parasheh edhe **subvencionimin e konsumatorëve të energjisë elektrike**. Sa i përket kësaj, pjesa e energjisë elektrike që ata paguajnë për energjinë elektrike që e marrin nga prodhuesit e energjisë nga BRE-të do të subvencionohet nga Qeveria e Kosovës. Kjo, pasi Qeveria në bazë të ligjit ka ndarë një shumë deri në 16 milionë euro, e cila do t'u jepet atyre prodhuesve përmes KOSTT-it.

**Për çdo KW/h të shpenzuar do zbritet në fatura 0.0061 cent**

**Nëse një konsumator ka shpenzuar 1000 KW/h gjatë 1 muaji, fatura do t'i vije 6.1€ më lirë**



**8 - 16 mil.€ për subvencionimin e BRE-ve**



Pra, mjetet do të derdhen në këtë kompani nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, ndërsa nga aty tek prodhuesit. Ky subvencionim do të zgjasë nga janari deri në maj 2021. Kjo nënkupton që shumica që e përfitojnë këta prodhues gjatë prodhimit nga BRE-të, do t'ju zbritet konsumatorëve në faturat e tyre. Në bazë të kalkulimeve del që konsumatorëve do t'ju zbritet në faturat e tyre çmimi prej **0.0061 cent për KW/orë** të shpenzuar nga tash deri në maj. Kjo nënkupton që nëse një konsumator ka shpenzuar **1000 KW/orë** gjatë 1 muaji, fatura do t'i vije **6.1 euro** më lirë. Pra, subvencionimi është i lidhur direkt me prodhuesit e BRE-ve, rrjedhimisht zbritja në euro lidhet me konsumin e energjisë elektrike.

**Për 5 muaj, qytetarët e Kosovës do kursejnë afërsisht 4-5€ në muaj nga faturat e energjisë elektrike**

## SA JANË ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE SI ÇAKTOHEN?

Çmimet e energjisë elektrike caktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë). Për kategorinë e konsumatorëve familjar çmimi mesatar i energjisë është **5.68 €cent/kWh**, ndërsa për konsumatorët jo-familjar çmimi mesatar i energjisë është **7.33 €cent/kWh**. Pjesëmarrja e konsumatorëve familjar në konsumin e përgjithshëm është rreth **57%**, ndërsa me **43%** marrin pjesë konsumatorët e tjerë.



**629,359 përfitues të këtij subvencionimi**





Tabela 3. Çmimi mesatar familjar dhe jo-familjar 2010-2019

Gjatë këtij viti janë regjistruar **24,157** njehsorë të ri prej të cilëve **20687** janë njehsorë familjarë kurse **3470** janë konsumatorë jo-familjarë, të cilët së bashku me njehsorët egzistues e arrijnë numrin total prej **629,359 njehësorë**.

## SA JANË ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE SI ÇAKTOHEN?


Mesatarja e shpenzimit të energjisë për konsumatorët familjarë është **431KW/h**, kurse për konsumatorët jo-familjarë kjo vlerë sillet rreth **1237 KW/h**. Këto të dhëna krahasuar me vitin e kaluar kanë një rritje prej **6%**, rritje kjo që pritet të shkojë edhe më lartë gjatë muajve në vijim.



**431 KW/h** mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për konsumatorë familjarë

2021 ka qenë rreth **33mil€**, për dallim prej **28mil€** sa ishtë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Prej tyre me subvencionimin nga Qeveria për BRE, qytetarët e Kosovës do të paguajnë fatuarat e tyre me një zbritje prej **9%**, përkatësisht rreth **2.9mil euro** më pak këtë muaj.

**2.9mil€** më pak në faturat e energjisë elektrike



## ÇFARË JANË TARIFAT NXITËSE DHE SI PËRCAKTOHEN?



**Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE)**, është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e energjisë në Kosovë. ZRRrE gjithashtu zbaton procedurën e autorizimit për zhvillimin e projekteve për BRE, lëshon licencat dhe poashtu cakton kushtet për funksionimin e këtyre projekteve. Krahas këtyre, ZRRrE harton edhe skema mbështetëse për të ndihmuar në financimin dhe realizimin e tyre. Këto skema përcaktojnë parimet aktuale të mbështetjes ose subvencionimit të energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të, të cilat përndryshe nuk do të ishin në gjendje që të konkurrojnë në tregun me shumicë.

Veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës drejtohen përmes Ligjit 05/L-081 për Energji. Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave rregullohen veprimtaritë e këtij sektori me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt me energji, të qëndrueshmërisë dhe cilësisë së lartë të energjisë, për të krijuar kështu kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues. Kjo synohet të arrihet duke promovuar shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e energjisë nga BRE-të përmes skemave mbështetëse dhe bashkëprodhimit, duke pasur gjithnjë në fokus mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet e energjisë.

Si skemë mbështetëse për investime në BRE-të janë edhe tarifatat nxitëse. Tarifatat nxitëse [ANG: Feed-in tariffs] janë një mekanizëm për nxitjen e investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të. Këto tarifa aplikohen si në vendet në zhvillim, ashtu edhe në ato të zhvilluara (BE-së, SHBA-së dhe më gjerë). Qëllimi kryesor i këtyre tarifave qëndron në promovimin e investimeve në BRE, prandaj edhe Kosova sikurse vendet e tjera ka adaptuar tarifën nxitëse si mekanizmin kryesor mbështetës. Kjo tarifë përdorë stimujt financiar për të arritur caqet për BRE-të.

## ÇFARË JANË TARIFAT NXITËSE DHE SI PËRCAKTOHEN?

Për të qenë i kualifikuar për skema mbështetëse për BRE, një objekt gjenerues duhet t'i plotësojë disa kritere. Këto kritere përfshijnë prodhimin e energjisë elektrike në një nga BRE-të primare. Gjithashtu, objekti duhet të jetë i vendosur brenda territorit të Kosovës dhe duhet të pajiset me stabilimente gjenerimi të reja dhe të papërdorura.

Me këtë Ligj është përcaktuar edhe politika e BRE-ve, e cila ka për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik dhe të qëndrueshëm të potencialeve vendore, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit e cila është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij Ligji janë përcaktuar përmes udhëzimeve administrative edhe caqeve të cilat janë pritur se do arrihen deri në vitin 2020.

### Tarifat nxitëse të aplikueshme për BRE

BRE	€/MWh
Era	85.00
Fotovoltaike	136.40
Hidrocentrale të vogla	67.47
Biomasa	71.30

Tabela 1. Tarifat nxitëse të aplikueshme për BRE gjatë vitit 2019

### Kapacitet e instaluar prodhuese nga BRE 2013-2019

BRE	€/MWh
Era	85.00
Fotovoltaike	136.40
Hidrocentrale të vogla	67.47
Biomasa	71.30
Gjithsej	93.77

Tabela 2. Kapacitetet e instaluar prodhuese për BRE 2013 - 2019

**Këto caqe për në vitin 2020 kanë qenë 25%, kurse për periudhën deri 2030 këto caqe ende nuk janë përcaktuar.**

Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e BRE-ve gjithashtu përcakton madhësinë maksimale të një projekti të vetëm të pranueshme për skemë si:

- 3 MW për panele fotovoltaike (PV),
- 14 MW për biomasë,
- 35 MW për erë,
- 10 MW për hidro.





## SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE PARA DHE PAS PANDEMISË

Pasojat e pandemisë COVID-19 janë vërejtur edhe në sektorin e energjisë elektrike. Këtë e vërteton edhe fakti se pandemia ka ndikuar në rritjen e konsumit të energjisë në sektorin e konsumatorëve familjarë në krahasim me periudhën e njëjtë të viteve paraprake. Kjo rritje dallohet në mesataren e konsumit të konsumatorëve familjarë e rritur prej 6%. Sa i përket konsumatorave komercial dhe industrial nuk është vërejtur ndonjë ndryshim rreth nivelit të konsumit.

Ritëm të njëjtë mund të dallojmë edhe në regjistrimet e njehsorëve të rinjë për vitin 2020. Gjatë këtij viti janë regjistruar **24,157** njehsorë të ri prej të cilëve **20,687** janë njehsorë familjarë, kurse **3,470** janë konsumatorë komercial dhe industrial, të cilët së bashku me njehsorët ekzistues e arrijnë numrin total prej **629,359 njehsorë**. Ky numër i njehsorëve të rinjë të regjistruar nuk ka ndonjë dallim prej viteve të kaluara, pasi që qëndron i përafërt me vitet e tjera.

Përpos tjerash, të dhënat rreth përqindjes së konsumit të përgjithshëm dhe mesatares në KW/h na japin një pasqyrë të qartë sa i përket konsumit të energjisë elektike për këto periudha. Mesatarja e shpenzimit të energjisë është për konsumatorët familjarë **431 KW/h**, kurse për konsumatorët komercial dhe industrial kjo vlerë sillet rreth **1,237 KW/h**. Këto të dhëna krahasuar me vitin e kaluar kanë një rritje prej 6%, vlerë kjo që pritet të rritet në vijim.



## SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE PARA DHE PAS PANDEMISË


Rritja e konsumit të energjisë është vërejtur edhe në procesin e faturimit. Faturimi i energjisë elektrike për muajin janar 2021 ka qenë rreth 33 milion euro, për dallim prej 28 milion euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Prej tyre me subvencionimin nga Qeveria për BRE-të, qytetarët e Kosovës do të paguajnë faturat e tyre me një zbritje prej 9%, përkatësisht rreth 2.9 milion euro më pak këtë muaj.

Kur flasim për rritjen e konsumit të energjisë elektrike, ky fakt konfirmohet edhe nga përfaqësuesit e ZRrE-së. Z. Pepaj, Drejtor Ekzekutiv në ZRrE, konfirmoi se “Konsumi i energjisë është gjithmonë në rritje. Prandaj kohë pas kohe ka edhe ngarkesë të rrjetit të furnizimit me energji elektrike dhe prishje të cilat pastaj shkaktojnë probleme edhe te konsumatorët qofshin ata familjarë apo jo-familjarë”. Ky trend i rritjes dallohet sidomos në ditët e ftohta, kur problemet me energji elektrike janë më të shpeshta sesa zakonisht.



Përderisa konsumi i energjisë elektrike është gjithnjë në rritje dhe nëse kjo rritje vazhdon me intensitetin e njëjtë, kërkesa për energji elektrike do jetë në disproporcion me prodhimin e energjisë. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e konsumatorëve, prodhuesit e energjisë elektrike do të kenë mundësi dhe leverdi për të prodhuar energji elektrike nga BRE-të, për të cilat Kosova dihet se ka një potencial të madh, sidomos për energjinë solare dhe atë të erës.





Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e  
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë të INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të  
konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).